

## **Abstrakti i temës: Roli i Gjykatës Evropiane në zbatimin e unifikuar të së drejtës komerciale të BE-së - Petrit Dedaj**

Ky punim shqyrton rolin vendimtar të Gjykatës së Drejtësisë së Unionit Evropian (GJDUE) në zbatimin e unifikuar të së drejtës komerciale të UE-së. Përmes analizës së jurisprudencës së saj, trajtohet se si Gjykata ka ndihmuar në zbatimin e unifikuar të legjislacionit komercial duke aplikuar një qasje të dyfishtë: *harmonizimin negativ*, përmes të cilit ka eliminuar barrierat kombëtare që pengojnë liritë themelore të lëvizjes, dhe *harmonizimin pozitiv*, ku përmes interpretimit të rregullativës ligjore të UE-së ka ndihmuar në standardizimin dhe zbatimin e njëtrajtshëm të rregullave komerciale në të gjitha shtetet anëtare.

Një aspekt kyç i trajtuar në këtë punim është përcaktimi i nomenklaturës së termave komerciale nga GJDUE. Në vendimet e saj, Gjykata ka qartësuar dhe unifikuar kuptimin e termave si 'mall', 'shërbim', 'kapital', 'punonjës' etj, duke siguruar që interpretimi i tyre të jetë i njëtrajtshëm në të gjitha juridiksionet e UE-së, e me të cilën janë reduktuar pasiguritë interpretative, e si rezultat, edhe ka kategorizuar terminologjinë e së drejtës komerciale të Unionit Evropian.

Punimi gjithashtu shqyrton rolin e GJDUE-së në kuadër të teorive të integritimit evropian. Në këtë kontekst, analizohet se si teoria neofunksionaliste e sheh Gjykatën si një motor të integritimit ligjor, ndërsa teoria e ndërqeverisjes liberale argumenton se shtetet anëtare e përdorin atë si një mjet për të ruajtur ekuilibrin midis sovranitetit të tyre dhe nevojës për një treg të përbashkët funksional. Debati midis këtyre qasjeve reflekton tensionin e vazhdueshëm mes juridiksionit supranacional të UE-së dhe autonomisë kombëtare.

Duke analizuar praktikën e GJDUE-së dhe rastet kyçe të saj, punimi arrin në përfundimin se jurisprudenca e Gjykatës ka ndihmuar në forcimin e një tregu të hapur, konkurrues dhe të drejtë brenda UE-së. Përmes vendimeve të saj, Gjykata ka luajtur një rol kyç jo vetëm në interpretimin e ligjeve të UE-së, por edhe në formësimin e vetë politikave të tregut të përbashkët.